



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
Ministry of Economic Development

Ministria e Zhvillimit Ekonomik në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, shpallë:

KONKURS

Titulli i vendit të punës: Menaxher i Projektit

Lokacioni: Prishtinë

Autoriteti: Njësia për Implementimin e Projektit “Kosova e Re” / Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Qeveria e Republikës së Kosovës

Përshkrimi i NjIP ‘Kosova e Re’

Njësia për Implementimin e Projektit (NjIP) termocentrali “Kosova e Re” (TCKR), e themeluar në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZhE), është sekretariat teknik i themeluar me vendim qeveritar me qëllim të implementimit të projektit për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re.

NjIP – TCKR shërben në kuadër të Komitetit Drejtues të Projektit si sekretariat teknik. Po ashtu, NjIP është përgjegjëse për menaxhimin teknik dhe administrativ të procesit si dhe ka rolin e dhënies së këshillave për realizimin e projektit.

Kohëzgjatja e kontratës

Menaxheri i Projektit do të zgjidhet për një periudhë 3 vjeçare me mundësi vazhdimi.

Kompensimi

Paga dhe kushtet tjera për këtë vend pune do të përcaktohen në marrëveshje.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Menaxheri i Projektit shërben si këshilltar për Komitetin Drejtues të Projektit dhe sipas nevojës Qeverisë së Kosovës, në të gjitha çështjet pa përjashtim për projektin TC “Kosova e Re”.

Dhënia e këshillave tek Komiteti Drejtues i Projektit dhe përgatitja e dokumenteve dhe vendimeve Menaxhimi i përditshëm i projektit të Termocentralit Kosova e Re dhe përgatitja e planeve vjetore të punës dhe planeve të detajuara të punës,

Mbikëqyrja dhe monitorimi i punës së Këshilltarëve të Transaksionit dhe konsulentëve tjerë që mund të angazhohet në Projekt,

Analizimi, komentimi, dhe diskutimi i të gjitha raporteve, rekomandimeve, dhe dokumenteve të përpiluar nga

Këshilltarët e Transaksionit apo konsulentëve të tjerë me qëllim që të sigurohet se janë në pajtueshmëri me vendimet dhe objektivat e KDP-së.

Kujdeset që të gjitha obligimet e Qeverisë së Kosovës si sponzorizuese e projektit përmbushen në mënyrë profesionale dhe në kohë.

Koordinojë aktivitetet lidhur me analizat, studimet, dhe procedurat tenderuese dhe kontraktuale që janë relevante për Projektin;

Rekomandon hapat e nevojshëm për realizimin e projektit tek KDP-ja

Mban komunikim të rregullt me të gjitha palët e përfshira në Projekt;

Mbledhja e të dhënave dhe analizimi i informatave me qëllim të realizimit të Projektit,

Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi rreth implementimit të Projektit.

Koordinimi i aktiviteteve të projektit me palët e interesuara ndërkombëtare dhe vendore

Siguron dhe përpunon të dhëna hyrëse për studime dhe nevoja të Projektit,

Shërbenë si pikë kontaktuese në kuadër të MZHE në lidhje me realizimin e Projektit.

Mbanë kontakte me zyrtarët dhe personelin e Qeverisë së Kosovës si dhe me palët tjera lidhur me zbatimin e vendimeve të KDP-së;

Udhëheq negociatat e marrëveshjeve të projektit me investitorin privat, institucionet financiare dhe kompanitë vendore private dhe publike

Përgatit takimet e KDP-se si dhe përgatiti raporte të rregullta të Projektit dhe paraqitja e tyre para KDP-së;

Ofrimi i orientimeve, detyrave dhe udhëzimeve tjera të nevojshme për Këshilltarët vendor dhe të jashtëm;

Raportimi i rregullt tek kryesuesi i KDP-së lidhur me aktivitetet në projekt dhe rekomandimi i hapave për realizimin e projektit

Mbikëqyrë dhe koordinojë çështjet e përditshme administrative dhe logjistike në lidhje me aktivitetet dhe Njesisë për Implementim të Projektit;

Të ketë integritet, etikë dhe ndershmëri profesionale për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit.

Kualifikimi dhe përshtatshmëria profesionale

Kandidati duhet të ketë:

Diplomë të nivelit Bachelor në fushën e drejtësisë, ekonomisë ose relevante.

Diploma Master konsiderohet përparësi.

Dëshmojë se ka të paktën 5 vite përvojë punë profesionale me

- institucione qeveritare
- institucione ndërkombëtare; apo
- sektorin privat

Eksperiencë në menaxhim të ekipeve të ndryshme, duke përfshirë përvojë me konsulentë ndërkombëtarë të fushave financiare, ligjore, dhe teknike,

Eksperiencë në implementimin e projekteve komplekse juridike-kontraktuale, financiare dhe ekonomike.

Njohuri lidhur me format e financimit të projekteve infrastrukturore.

Njohuri lidhur me funksionimin e institucioneve financiare dhe produkteve që ato ofrojnë, kreditë dhe garancionet, përfshirë eksperiencë në negociim me institucione financiare për projekte infrastrukturore.

Njohuri lidhur me sektorin e energjisë dhe minierave.

Dëshmojë aftësi të njohjes së gjuhës angleze.

Aftësi të mira të shfrytëzimit të programeve kompjuterike.

Të ketë një prapavijë specifike në mbështetjen e zbatimit të projekteve zhvillimore infrastrukturore në projekte identike ose të ngjashme.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURRIMIT

Kandidatët për Menaxher të Projektit duhet të dorëzojnë këto dokumente (Dështimi për ta bërë këtë do të rezultojë në refuzimin e aplikacionit):

- ✓ Kërkesa për punësim - mund ta gjeni në Web faqen <http://mzhe.rks-gov.net>.
- ✓ Diploma e nivelit bachelor dhe master e noterizuar/ diploma nga universitete jashtë Kosovës e nostrifikuar
- ✓ Dëshmi mbi njohurin e gjuhës angleze, përmes dorëzimit të:
 - një certifikate të testit TOEFL me mesatare mbi 90
 - diplomë universitare që është përfituar nga studimet në gjuhën angleze të nivelit bachelor apo master
 - dëshmoj se ka së paku 5 vite përvojë pune relevante në pozitë menaxheriale në një kompani apo institucion ku gjuha angleze ka qenë gjuhë zyrtare
- ✓ CV
- ✓ Letër motivimin duke ofruar një shpjegim të qartë se si aftësitë përputhen me kërkesat e detyrës.
- ✓ Dëshmi mbi përvojën e punës.
- ✓ Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- ✓ Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikantët duhet të përgatisin dhe dorëzojnë një prezantim ku propozon procedurën dhe metodologjinë e menaxhimit të këtij projekti. Prezantimi duhet të paraqes qartë procedurat dhe mekanizmat e procesit që duhet ndjekur deri tek përmbylljen financiare e projekti, çështjet kryesore që duhet të trajtohen, politikat e rëndësishme globale dhe lokale që mund të kenë impakt në zhvillimin e projektit, instrumentet financiare që mund të jenë të nevojshme dhe arsyeshmëria për ato instrumente, akterët që janë të përfshirë dhe më të cilët duhet të negociohet/dialogohet, si dhe të paraqet në detaje strukturën e “projekt finance” ku një projekt publik financohet dhe operohet nga sektori privat. Prezantimi duhet të parasheh disa nga hapat kryesor deri në ditën e operimit të termocentralit referuar marrëveshjeve komerciale të cilat janë publike. Në rast të plagjiaturës, kandidati automatikisht do të diskualifikohen.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur (të shkruhet emri dhe mbiemri si dhe titulli i pozitës në të cilën aplikon kandidati) dhe të dorëzohen në MZHE, zyra nr. 102 (Arkiva) , Adresa Rruga “Nena Tereze” Nr.36 Prishtinë.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes Nr. kontaktues 038/ 200 21524.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Dokumentacioni i kompletuar sipas kërkesave duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur (të shkruhet emri dhe mbiemri si dhe titulli i pozitës në të cilën aplikon kandidati) dhe të dorëzohen në MZHE, zyra nr. 102 (Arkiva), adresa; Rruga “Nena Tereze” Nr.36 Prishtinë.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë. Vlerësimi formal i kandidatëve dhe intervista do të bëhet në një kohë optimale pas përfundimit të afatit për aplikim. Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes Nr. kontaktues 038/ 200 21524.

Njësia për Implementimin e Projektit “Kosova e Re” / Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Qeveria e Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe mirëpret aplikimin nga persona të gjinisë mashkullore e femërore dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Afati i konkurrimit është prej datës 26 mars 2019 deri me date 10 prill 2019, deri në orën 16:00.
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.